

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Gani Zabeli, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Shaban Prekalla, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.B., nga ... Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPRK, duke vendosur përkitazi me ankesën të mbrojtësit të akuzuarit B.B. – avokat B.K., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, P.nr.76/18, datë 18.04.2019 në seancën e kolegjit të mbajtur më 20.08.2019, mori këtë :

### A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit B.B.-av.B.K., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren–Dega në Suharekë, P.nr.76/18, datë 18.04.2019, **Vërtetohet**.

### A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prizren – Dega në Suharekë, me aktgjykimin P.nr.76/2018, datë 18.04.2019, të akuzuarin B.B. për shkak të veprës penale Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPRK-së, e ka shpall fajtor dhe e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 700 (shtatëqind) €, të cilën gjobë është obliguar që ta paguaj në dy këste të barabarta duke filluar 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas plotë fuqishmërisë të këtij aktgjykimi, po që se dënimi me gjobë nuk mund të realizohet as detyrimisht i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi prej 35 ditësh duke llogaritur për 20 €, një ditë burg, konform nenit 46 par.3 të KPRK-së. Është obliguar i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzet) € dhe taksën për kompensimin e viktimave në shumë prej 30 (tridhjetë) €. Konform dispozitës të nenit 374 par.3 lidhur me nenin 69 të KPRK-së, ndaj të akuzuarit B.B. është shqiptuar edhe dënimi plotësues, marrja e sendit ashtu që prej të akuzuarit është marrë një “sprej” me mbishkrimin “Protect” dhe një “boks i hekurit”.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

Mbrojtësi i të akuzuarit B.B.-avokat B.K.dhe atë sa i përket vendimit mbi dënimin me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim dukshëm më i butë ose të njëjtit ti shqiptohet një dënim me kusht.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.1000/2019, datë 16.08.2019 ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

### **Ankesa nuk është e bazuar.**

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk animohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të Ligjit Penal në dëm të akuzuarit.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimin që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Mbrojtësi i të akuzuarit e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke pretenduar se i mbrojturi i tij e ka mbajtur në posedim “armën sprej” dhe se nuk e ka ditur se me veprimet e veta gjegjësisht mjetin “sprej” të cilin e ka mbajtur përbën veprë penale dhe se i njëjti shkakton rrezikshmëri dhe pasoja të rënda për shëndetin e njeriut dhe aq më tepër privimin e jetës. Më tutje mbrojtësi në ankesë thekson se mbrojtësi i tij është familjar-prind, mbajtës i vetëm i familjes, i padënuar më parë, se asnjëherë nuk ka rënë në kundërshtim me ligjin dhe se është hera e parë që ka kryer një veprë të tillë, krejt këtë e ka bërë nga mos njohuria që mjeti i lartcekur hyn në grupin e veprave penale, nga gjitha këto propozon që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe ndaj të mbrojturit të tij të shqiptohet një dënim dukshëm më i butë, ose dënim me kusht pasi që konsideron që dënimi i shqiptuar ndaj të mbrojturit të tij nga Gjykata e shkallës së parë është tejet i lartë.

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet ankimore të mbrojtësit që të shqiptohet një dënim më i butë nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPPK-së. Si rrethana lehtësuese ka marr pranimin e fajësisë, qëndrimin e tij korrekt, pendimin për veprën e kryer, ndërsa rrethana rënduese dhe posaçërisht rënduese nuk

gjeti dhe të akuzuarit i shqiptoj dënim si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar me bindje se edhe me dënimin e lartë cekur do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitat përkatëse ligjore. Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kolegji i kësaj gjykate dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat ndikojë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, pretendimet e mbrojtësit e të akuzuarit për një dënim më të butë ndaj të akuzuarit, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të bazuara, ngase duke marrë parasysh peshën e veprës penale dhe rrethanat të cilat i ka konstatuar dhe vlerësuar gjykata e shkallës së parë e meqenëse në ankesën e mbrojtësit nuk theksohet ndonjë rrethanë e re lehtësuese apo posaçërisht lehtësuese e që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë e që do të ndikonte në një dënim më të butë ndaj të akuzuarit, kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, ndaj të akuzuarit është në përpjesëtim me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky dënim do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve, se me dënimin e shqiptuar kryerësi do ta parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të neni 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

## **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**

PA1.nr. 984/19, datë 20.08.2019

Zyrtari ligjor  
Shaban Prekalla

Kryetari i kolegjit  
Hashim Çollaku

### **Anëtarët e kolegjit:**

Ferit Osmani  
Gani Zabeli